# Grabitësit e lidhin me rrip rojën e një firme private në Graçanicës dhe ia marrin parat

LAJME



10/07/2025 09:34

**Një rast i grabitjes është raportuar të ketë ndodhur dje në fshatin Dobratin të Graçanicës.**

Policia e Kosovës njoftoi se grabitja ka ndodhur në ora 00:30, ku theksohet se grabitësit hyn në një firmë private ku edhe kryen grabitjen.

Sipas raportit, roja i kësaj firme është lidhur nga grabitësit me rrip dhe më pa ia kanë marrë 200 euro, transmeton lajmi.net.

"Ankuesi mashkull kosovar ka njoftuar policinë se derisa ishte në vendin e punës (roje në një firmë private) aty kanë hyrë dy të dyshuar të panjohur, të maskuar, njëri me pistoletë në dorë e kanë lidhur viktimën me një rripë lëkure dhe nga ai kanë marrë kuletën në të cilën kishte dokumente personale dhe rreth 200 € para të gatshme", transmeton lajmi.net.

Gjithashtu të dyshuarit, pasi kanë hapur me forcë një dhomë tjetër kanë marrë nga dollapi rreth 2500 euro të gatshme dhe kanë ikur nga vendi i ngjarjes.

Rasti është nën hetime.**/Lajmi.net/**

**Më shumë nga uebi** nativeGRAM
















## LAJME TË FUNDIT


Rama shpreh ngushëllime për kapitenin që vdiq duke...


Katër gjyqtarë të rinj do t'i shtohen Departamentit...



Një person i vdekur dhe katër të lënduar...



Çitaku: Krimi në sektorin e energjisë po kontrollohet...

## Artikuj të ngjashëm


July 10, 2025

Rama shpreh ngushëllime për kapitenin që vdiq duke shpëtuar dy turistë:...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr.



©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved Privacy Policy